



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2023, merr këtë

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 01998-1, me sipërfaqe të përgjithshme 208318 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-01998-1, Zona kadastrale Çagllavic, Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 035-186861, dt. 02.10.2013.
  2. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, janë parcelat kadastrale, nr. 00578-4, me sipërfaqe 3426 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00578-4, pjesa e parcelës kadastrale, nr.00578-5, me sipërfaqe 33101m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P - 71914032-00578-5, pjesa e parcelës kadastrale 00578-7, me sipërfaqe 1283 m<sup>2</sup>, Certifikat e pronës, nr. P-71914032-00578-7, pjesa e parcelës kadastrale 00574-2, me sipërfaqe 14240 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronës, nr. P-71914032-00574-2, në pronësi të Rahman( Haradin) Haradinit, dhe parcela kadastrale, nr. 00574-3, me sipërfaqe 32640 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronës, nr. P-71914032-00574-3, Zona kadastrale Zllatar - Prishtinë, në pronësi të: Rahman (Haradin)Haradinit dhe Shaban (Osman) Konxhelit, me sipërfaqe të përgjithshme 84690 m<sup>2</sup>, me destinim gjelbërim, të planifikuar sipas Planit rregullues, sipas Planit zhvillimor komunal, i miratuar me Vendimin, 01. nr. 031-156871, të dt. 27.08.2013.
- III.** Këmbimi i pronave të paluajtshme me pronarët e cekur në pikën **II** të Vendimit, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-186861, të dt. 02.10.2013.

- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehen.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII.** Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
  - kopjet e planit dhe
  - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-020/04-236518/23, më 26.12.2023

**KRYESUES I KUVENDIT**  
Pëllumb Bajcinovci





## Arsyetim

Përgjigjja nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit nr.2678-2/20, dt. 22.12.2020, ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 1998-1, me sipërfaqe 208318 m<sup>2</sup>, Z.K Çagllavicë Prishtinë në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim për ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e re - Zona qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr. 035-186861, dt. 02.10.2013 dhe parcelat kadastrale nr. 578-4, sipërfaqe 3426 m<sup>2</sup>, 578-5, sipërfaqe 33101 m<sup>2</sup>, 578-7, sipërfaqe 1283 m<sup>2</sup>, 574-2, sipërfaqe 14240 m<sup>2</sup>, në pronësi të Rrahman (Haradin) Haradinit dhe parcela kadastrale me nr. 574-3, sipërfaqe 32640 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Zllatar Prishtinë, në pronësi të Rrahman (Haradin) Haradinit dhe Shaban (Osman) Konxhelit, me sipërfaqe totale prej 84690 m<sup>2</sup>, me destinim gjelbërim.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Prishtina e re - Zona qendër", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01 nr. 035-186861, dt. 02.10.2013 dhe Përgjigjja nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Parcelat kadastrale nr. 578-4, sipërfaqe 3426 m<sup>2</sup>, 578-5, sipërfaqe 33101 m<sup>2</sup>, 578-7, sipërfaqe 1283 m<sup>2</sup>, 574-2, sipërfaqe 14240 m<sup>2</sup>, në pronësi të Rrahman (Haradin) Haradinit dhe parcela kadastrale me nr. 574-3, sipërfaqe 32640 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Zllatar Prishtinë, në pronësi të Rrahman (Haradin) Haradinit dhe Shaban (Osman) Konxhelit, me sipërfaqe totale prej 84690 m<sup>2</sup>, shtrihen në gjelbërim të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.